



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 01-060/01-0006987/26
Data 20.02.2026
Data



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe ne pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

THËRRET

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 27.02.2026, (ditë e premte), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit

Mbledhja do të ketë këtë:
REND DITE

1. Fjala hyrëse,
2. Miratimi i rendit të ditës,
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
4. Propozim-vendim për Formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Regjionale të Mbeturinave Uniteti SH.A Mitrovicë, (raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).
5. Propozim-vendim për Formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale Eko –Natyra SH.A, Skenderaj,(raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).
6. Propozim-vendim për zgjedhjen e përfaqësuesve të Komunës së Skenderajt për Asociacion të Komunave të Kosovës,(raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).
7. Propozim – vendim për Formimin e Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave, (raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).
8. Propozim – vendim për Formimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Procesin e Zgjedhjes së Këshillave të Fshatrave, (raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku).
9. Propozim – vendim për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01-020.01-0004914/26, i datës; 03.02.2026, për Formimin e Komitetit për Politik dhe Financa. (raporton Kryesuesja e Kuvendit znj Adelina Spahiu Alija).
10. Propozim - vendim për iniciimin e procedurës së hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës së Skenderajt për vitin 2026- 2034, (raporton drejtori i urbanizmit z. Arbnor Çitaku).
11. Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme.

KRYESUESJA E KUVENDIT


Adelina Spahiu-Alija

ASpahiu





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 30.01.2026, ora 10:00

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse,
2. Miratimi i rendit të ditës,
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara,
4. Propozim-vendim për Formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), Komuna Skenderaj, (Raporton Kryetari i komunës **z.Sami Lushtaku**).
5. Propozim-vendim për Formimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendësdrejtor, Komuna Skenderaj, (Raporton Drejtori i DKA-së, **z.Kastriot Duraku**).
6. Shqyrtimi i Raportit të Punës së ekzekutivit të komunës së Skenderajt, për vitin 2025, (Raporton Kryetari i komunës **z.Sami Lushtaku**).
7. Shqyrtimi i Raportit Financiar të buxhetit të komunës së Skenderajt, janar-dhjetor 2025, (Raporton Drejtori i DBF-së, **z.Behxhet Maliqi**).
8. Propozim-vendim për miratimin e Raportit Përfundimtar Nr.09-052/01-0052869/25, i datës 18.12.2025, i hartuar nga komisioni komunal, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara kryesisht nga zjarret, era, breshëri, ngricat dhe fatkeqësitë tjera, për muajin Korrik-Dhjetor 2025, (Raporton Drejtori i DSHP, **z.Arber Geci**).
9. Propozim-vendim për Rishqyrtimin e Vendimit Nr.01-020/01-0000460/26, i datës 05.01.2026, për Formimin e Komitetit për Politik e Financa (KPF), (Raporton Kryesuesja e kuvendit, **znj.Adelina Spahiu-Alija**).
10. Pikë shtesë propozim për rishqyrtimin e vendimit nr 01-463/04-00000466/26 i datës; 05.01.2026 për miratimin e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim personave fizik / juridik për vitin 2026, raporton Kryetari i Komunës **z. Sami Lushtaku**.
11. Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme.

Kryesuesja e kuvendit, Adelina Spahiu: I nderuar nënkryetar i komunës **z. Fadil Nura**, të nderuar anëtar të kuvendit, dhe gjithë ju të pranishëm, në sallë janë 27 anëtar, para vetes keni një propozim shtesë për rishqyrtimin e vendimit nr 01-463/04-00000466/26 i datës; 05.01.2026 për miratimin e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim personave fizik / juridik për vitin 2026, kush është që kjo pikë të hynë pikë shtese, konstatojmë se me 23 vota për, asnjë kundër dhe 3 abstenime hynë në rend dite propozimi

për rishqyrtimin e vendimit nr 01-463/04-00000466/26 i datës; 05.01.2026 për miratimin e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim personave fizik / juridik për vitin 2026, vazhdojmë me piken e radhës miratimi i rendit të ditës, e hap debatin, fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, instituti Gap ka bere një publikim e që Kryetari i Skenderajt nuk ka bere asnjë premtim, propozoj si pike me pas një informate se çka synon zotëri Lushtaku në mandatin e tij qeverisëse me i pas do informata në këtë raste ka thënë se 24 ore është në dispozicion e që këto dite ishe vizit në Libi e me na tregu lidhur me atë vizit.

Kryesuesja; Atëherë shkojmë me votim për propozimin e Hysni Mehmetit, Konstatojme se me 3 vota për, 22 kundër dhe 2 abstenime nuk kalon propozimi në fjale, vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, shkojmë me votim konstatojmë se me 22 vota për, 4 kundër dhe 1 abstenim miratohet rendit i ditës, vazhdojmë me piken e radhës, shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e hap debatin nuk ka për debat, shkojmë me votim, konstatojmë se me 27 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar, vazhdojmë me piken e radhës Propozim-vendim për Formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), Komuna Skenderaj, për këtë pike raporton nënkryetari i komunës z. Fadil Nura.

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura: Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë ju të pranishmit, kam kënaqësi ta paraqes këtë propozim për formimin e këshillit për siguri në bashkësi, organ mjaftë i rëndësishëm, i shihni ankeret që duhet qene pjesë e këtij këshilli, të cilin komitet e udhëheqë Kryetari i Komunës, nuk po i lexoj akteret që të cilët i keni në propozim vendim, propozoj që ta përkrahni në mënyrë që ta funksionalizojme këtë këshill, faleminderit.

Kryesuesja: Faleminderit nënkryetar, e hape debatin për këtë pike të rendit të ditës, pasi nuk ka për debat, shkojmë me votim konstatojmë se me 22 për asnjë kundër dhe 4 abstenime miratohet Propozim-vendim për Formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), Komuna Skenderaj, vazhdojmë me piken e radhës Propozim-vendim për Formimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendës drejtor, Komuna Skenderaj, Raporton Drejtori i DKA-së, z. Kastriot Duraku.

Kastriot Duraku, DKA – Fjala përshëndetëse, para jush paraqes Propozim-vendim për Formimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendës drejtor, ky propozim është i bazuar në legjislacionin, në këtë komision nga DKA propozojmë zyrtaren Shkendije Idrizi, nga këshilli i prindërve propozojmë Avdi Jakupin, si dhe një përfaqësues nga MASHTI, kërkoj nga ju ta përkrahni këtë propozim – vendim.

Kryesuesja; Faleminderit drejtor, e hap diskutimin për këtë propozim – vendim, pasi që nuk ka për diskutim, shkojmë në votim konstatojmë se me 22 vota për asnjë kundër dhe 4 abstenime, miratohet Propozim-vendim për Formimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendës drejtor, Komuna Skenderaj, vazhdojmë me piken e radhës, Shqyrtimi i Raportit të Punës së ekzekutivit të komunës së Skenderajt, për vitin 2025.

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura: Fjala përshëndetëse, para jush e keni raportin e punës së ekzekutivit për vitin 2025, është një raport që pasqyron punët dhe aktivitetet e vitit 2025, neper të gjitha drejtorit i shihni punët që janë kryer neper drejtori, pavarësisht sfidave të buxhetit, që kemi pasur me kontrate kolektive na ka penalizuar në realizimin e disa projekteve, e dini se për punët e mira që janë bere kemi fituar edhe grandin e performances, nuk po e zgjati unë me shume.

Kryesuesja: Faleminderit nënkryetar, e hap diskutimin.

Afrim Kabashi-NSD: Fjala përshëndetëse, urime për drejtorët e ri ju uroj suksese në mandatin tuaj, dhe uroj bashkëpunim, lidhur me raportin e kam lexuar që nga fillimi deri në fund e që do të

paraqes këtu, po filloj nga këshillat e fshatrave pse nuk janë formuar kur e dimë se mandatin e kaluar e kemi formuar një komision këtu ne kuvend për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, pastaj te drejtorja e administratës në faqe 12 për sistemin Smaed për cilin sistem behet fjalë për çka përdoret, pastaj te drejtorja e urbanizmit janë të cekura disa pune të kryera si asfaltimi i rrugëve me sa e di unë në fshatin Polac asnjë rrugë nuk është asfaltuar në vitin 2025, pastaj te ndriçimi publik e ka cek se është realizuar, në Polac ka mbetur gjyse, a do të vazhdoj, si dhe për ujërat të zeza a do të trajtohen për fshatin Polac, si dhe në bujqësi me precaktu kritere për përfitues të grandëve .

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura: Faleminderit për pyetjet, sa i përket këshillave të fshatrave, e dini se e kemi formuar komisionin këtu nga Kuvendi, mirëpo problemi është sepse nuk kemi buxhet me i përkrah këtu qëndron problemi, ky problem qëndron po thuhet në të gjitha Komunitet, pa nda buxhet është problem me i funksionalizimi këta këshilla, sa përket sistemit Smaed është program që menagjon IT bashkë me ASHI, është sistem i administratës, sa i përket ndriçimit publik është projekt që është realizuar e do vazhdon edhe në vazhdim me u realizuar, ndërsa rreth pyetjes së kanalizimit në Polac i kemi zgjedh disa probleme në disa lagje në Polac e që do vazhdojmë edhe në ato lagje ku kemi mbetur gjysmë.

Behxhet Maliqi, DBF – Faleminderit Kryesuesë, përshëndetje për të gjithë urime për mandatin për të gjithë, të gjitha thirrjet në bujqësi janë dal me kritere për secilën thirrje.

Floriana Halili, LVV- Faleminderit e nderuara Kryesuesë, përshëndetje për të gjithë, tek drejtorja e bujqësisë trajnime për fermer, kush i ka mbajtur këto trajnime, a i kanë ftuar të gjithë fermerët në këto trajnime, si dhe të mjetet bujqësore, sa i keni respektuar kriteret sepse kemi dëshmi se ka fermer që nuk ka as traktor e ka marr mjetet bujqësore e ato mjetet bujqësore e të cilat i kanë qit në shitje, si dhe disa përfitues të njëjtit përfitojnë edhe grandë tjerë, si dhe të subqendra në Runik e pasni bërë vazhdim, nuk e di se çfarë është bërë me atë subqender, te drejtorja e arsimit e keni cek se janë se 27 institucione janë pajisur me kamera, nëse mundesh me na tregu se gjatë këtij viti a jeni shku me i kontrollu sa kamera janë në funksion, a mundesh me na tregu sa ligjëratat janë mbajtur në shkollat tona, nga Policia si dhe a jeni në dijeni se në shkollat tona ka raste që përdoren narkotik.

Nezir Bejta, LVV- Përshëndetje për të gjithë me qene se vij nga fusha e arsimit, fokusi i imë është arsimi e pasqarë në këtë raport tek drejtorja e arsimit furnizimi i shkollave me mjetet të konkretizimit, është krejt në rregull por sjan të mjaftueshme ato mjetet, e keni përmend kabinetin e fizikes kimisë e keni furnizuar me mjetet konkretizuese, mirëpo ma primare është diçka tjetër në ato kabinete nuk ka banka as karriga, te kabinetin i kimisë nuk ka as tavolina pune, nuk ka as ujë për eksperimente, mungojnë substancat, dhe tjetër problem kabinetin i biologjisë është bashkë me të kimisë ka acide ato që është rrezik, tjetër në shkollë nuk ka projektor janë vetëm tri tabele të mençura, qato tri tabele lëvizin nga klasa në klase. Duhet të furnizohen klasat me projektor dhe tabela të mençura, si dhe dukuri tjetër është regjistrimi i nxënësve pa kritere mos e degradoni gjimnazin, po pranoni nxënësi si kanë përsëritur në teknik dhe profesionale, si dhe dukuri tjetër në klasë të 10 nuk janë të regjistruar nxënësit në ditar, edhe diçka tjetër Arifon Dragaj vitin e kaluar e ka nxënë vendin e dytë në lenden e fizikes i keni premtuar shpërbimin sja keni jap, është fytyrë për ata nxënësi si i premtohen shpërbimi e nuk ja jepni, unë e kam një letër këtu shihen çmimet e premtuar e që nuk i keni realizuar, tjetër është fotokopjimi i testeve nga arsimtaret që ju duhet të shpenzohen jashtë shkolle me i fotokopju testet, pastaj tek parku Idriz Rreci, nuk ka tabelë aj park, dhe të ndërtohet një buste të Idriz Rrecit,

Kastriot Duraku, DKA –Faleminderit kryesuesë u mundova të përmbledhi të gjitha pyetjet e marra, të kamerat në klasa i kemi të ndaluar me i vendos, vetëm jashtë i kemi vendos korridore, sa i përket ligjëratave i bëjnë policia me psikolog tone, ka tematike të ndryshme, rreth sigurisë e

tema tjera, çdo dy tre muaj i mbajnë, për përdorim të lendeve narkotike nuk kemi informacione se përdoret, janë policët neper shkolla, të profesorit Nezir, gjimnazin e kemi furnizim me kabinete, banka karrige, tabele të mençura, projektor, laboratorin i kemi furnizim, ka nevojë ende më i furnizim, mirëpo kemi mungesë të buxhetit e dimë kontrata kolektive na ka penalizim, në gjimnaz janë 6 tabele të mençura, e kam prurë edhe trajnerin më i trajnuar për përdorim për tabelat, të regjistrimi i klasave të 10 mungesa e normës së profesorëve na u duhet për shkaktuar të mungesës së nxënësve aplikuesve i marrim edhe me notën 4 sepse mbesin pa punë mësimdhënësit, për shpërblimet e nxënësve i kemi shpërbluar mirëpo me vonës e vërtet për shkaktuar të buxhetit, të fotokopjet e vërtet se kemi mungesë toneri sepse menagjohet nga AqP niveli qendror por presim që me kontratë të re të furnizohen se shpejti.

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura – Faleminderit prof, ke kontribuar gjatë në arsim e njëh mirë këtë fushë, mirëpo rreth çështjeve të mjeteve konkretizuese duhet ta kemi parasysh se nuk kemi buxhet sepse kontrata kolektive na ka penalizuar, ndërsa për parkun kemi investuar vetëm ka mbetur të vendoset busti i tij me bashkëluftëtar të vendoset aty, a për tabele kam menduar që është e vendosur tabela.

Behxhet Maliqi, DBF –Faleminderit Kryesues, faleminderit për pyetjet të gjitha thirrjet në bujqësi kanë qenë me kriteret e përcaktuar, tek grandet ka qenë kriteri traktori në të gjitha vizitat që janë bërë ka pasur traktor fermerët, komisioni i drejtorisë ka bërë punë të shkëlqyeshme, dhe të gjitha këto grandet kanë monitorim 3 vjeçar.

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura – Për subqendren e Runikut ky projekt ka hyrë në rivizim, ministria ka me realizuar pjesën e vetë të projektit.

Kastriot Duraku, DKA –Faleminderit Kryesues, tash me erdh informata, në Gjimnaz janë 6 tabele të mençura prej të cilave 2 janë dhënë KQZ për trajnime.

Nezir Bejta, LVV- Drejtor nuk është mirë më i justifikuar këto, në gjimnaz të ri kanë qenë 3 tabele të mençura, 2 janë të kabinetit të informatikës, ndërsa për Arifon Dragen nuk ka marrë shpërblim mos i diskriminoni, veç nëse këtë vit ja jepni shpërblimin.

Kastriot Duraku, DKA –Pra po të tregoj se 4 tabele janë në gjimnaz e 2 ju kanë dhënë në shfrytëzim KQZ deri ti kryejnë trajnimet, nëse done shkojmë i këqyrem bashkë e vërtetojmë këtë, për shpërblime të tregova edhe më herët, se shpërblimet i për vitin e kaluar këtë vit, prof merr informata me të sakta e pastaj fol, shkojmë bashkë e i shikojmë.

Floriana Halili, LVV- Faleminderit Kryesues, desha të ndërlidhem të drejtorja e bujqësisë ku i kemi identifikuar rreth 80 persona përfitues që nuk kanë traktor ata nuk merren hiq me bujqësi, këtë çështje mundën me se miri komisioni me e tregu, të drejtorja e arsimit a mundet të mbahen ligjëratat 1 herë në muajt dhe në cilat shkolla i mbani ligjëratat.

Rezarta Hasani – Ibrahim, PDK- Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë, unë kam vetëm në çështje të renovimit të AMF në Rezall, ajo AMF është rinovuar në vitin 2024 e jo në vitin 2025, pastaj janë të cekura 8 AMF funksionale e në të vërtetë janë 4 AMF funksionale.

Hysni Mehani-LVV: Faleminderit, rreth këtij raporti kisha pasur dëshirë se secili drejtor me i pas 2 apo 3 të arritura në raport, që i ka realizuar secili drejtor, shembull të drejtorja e shëndetësisë e kisha falenderu drejtorin nëse e kish rregullu liftin në QKMF ku po maltretohen pacientët në mungesë të liftit, pastaj probleme të analizat një pjesë e analizave bëhen në QKMF e pjesa me e madhe e tyre në privat, kisha kërkuar me u shtu shërbimi i analizave në QKMF, pastaj në bujqësi kisha dashur që në grandet me u respektuar kriteret se të gjithë e dimë se si ndahen këto grandet, të shërbimet publike me u rregulluar parku Idriz Rreci, të administrata me qenë më hapur qasja qytetar zyrtar, muret aty mos me qenë më qasja më e lirë me qytetar, pastaj të inspektorati mos e i dënu bizneset vetëm pse kanë bindje tjera politike.

Kastriot Duraku, DKA – Secila shkollë e ka buxhetin e saj, qe menaxhojnë vete me buxhet, ndërsa për gjëra elementare të Shkollave, material shpenzues nuk ju mungojnë asnjë Shkollë këto.

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura – Faleminderit Kryesues, për çështjen e liftit në QKMF, është me se e nevojshme i kame inicuar procedurat për pajisje me lift, mirëpo mungesë buxheti, e shpejti do ta rregullojmë atë çështje, për parkun Idriz Rreci është kryer shumica e punëve ka mbetur vetëm edhe busti, për reforma në administratë, nuk nënkupton reforme vetëm muret me i largu, mirëpo me se e nevojshme kishte me qenë hartimi i një statuti të Komunës i cili ka mbetur i vjetër, e qe do ta rregullonte mirë çështjen e shërbimeve dhe do të përcaktonte detyrat dhe shërbimet e secilit sektor e drejtori.

Hysni Mehani-LVV: Nuk e thashë në atë kuptim murin neper drejtori, mirëpo qasjen në shërbime si dhe është e nevojshme me u definu secila drejtori punët dhe detyrat e tyre.

Kryesuesja: Pasi qe nuk ka tjerë për diskutim, shkojmë në votim, konstatojmë se me 23 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, përkrahet raporti i Punës së ekzekutivit të komunës së Skenderajt, për vitin 2025, vazhdojmë me piken e radhës Shqyrtimi i Raportit Financiar të buxhetit të komunës së Skenderajt, janar-dhjetor 2025, raporton drejtori i DBF.

Behxhet Maliqi, DBF – Faleminderit Kryesues, ju kërkoj falje qe na është deshtë me sjell një raport tjetër me disa ndryshime të vogla, për shkak të një gabimi teknik qe ka rrjedh nga sistemi, ky raport përfshin shpenzimet dhe realizimet e buxhetit për periudhën janar – dhjetor 2025, i bazuar në ligjet për financa dhe akte tjera nenligjore, në këtë raport i shihni rrjedhën e parasë realizimin e buxhetit neper drejtori, të ndar neper kategori ekonomike e drejtori, në tabelën e parë e shihni buxhetin fillestar prej 19,881,471.00€ si dhe buxhetin aktual final 20,856,499.07€ pasataj pjesë e tabelës së parë e shihni fondet burimore si granditë e përgjithshme, të hyrat vetanake të hyrat e bartura huamarrje e jashtme e shihni buxhetin fillestar si dhe realizimin me përqindje, pastaj në tabelën numër 2 të hyrat vetanake neper drejtori gjatë periudhës janar – dhjetor 2025, e shihni planifikimin dhe realizimin e tyre, tabela nr 3 analitika e shpenzimeve buxhetore në nënkategori neper kode ekonomike qe i shihni në tabele, pastaj tabela 4 projektet kapitale buxhetin e planifikuar dhe realizimin e tyre, shihni në tabele si dhe tabelën e fundit me nr 5 shpenzimet sipas programeve paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shërbime komunale si dhe subvencione dhe transfere, nuk po e zgjati me shume u mundova në pika të shkurtuara, nëse keni ndonjë pyetje jam i gatun për përgjigjeje, faleminderit.

Kryesuesja: Faleminderit drejtor, e hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës, fjalën ja kaloj

Afrim Kabashi-NSD: Faleminderit Kryesues, mirë qe janë vërejtë këto gabime teknike në raport, sepse nuk na bëjnë nder askujt ato gabime, jam mundu me shiqu këtë raport financiar të buxhetit i vitit 2025, buxheti i miratun i komunës sonë për vitin 2025 është 19,881,471.00€, duke përfshi të hyrat vetanake në shume prej 1,709,466.00€, janë dy shuma të realizimi i të hyrave vetanake njëra 1,767,821.09€, cila është shuma e realizimit të të hyrave vetanake po du me dite, tash a janë realizu plani i planifikun a janë tejkalu realizimi i të hyrave, pastaj shpenzimet në paga 11,800,066.30€ tri herë në tabele e ke përmend kategorinë e pagave e me vlera të ndryshme, pastaj vendimet gjyqësore, kanë paguar 1,589.12€, cilat vlera janë të sakta të këtyre vlerave të vendimeve gjyqësore në faqen 12, tek analitika e shpenzimeve buxhetore faqe 7 shërbime kontraktuese tjera çka keni pagua këtu, subvencione për entitetet jopublike dhe transfere për përfitues individual tjerë, çfarë pagesa janë këto faleminderit

Behxhet Maliqi, DBF – Faleminderit për pyetjet, realisht ju ke referu dy dokumenteve të ndryshme e sqarova për dokumentin e parë dhe të fundit, nëse don sqarime më të sakta më në detaje të kisha jap sqarime me në detaje në drejtori, për paga ka ndodh rritje e pagave e ka dallim në vlerë në raport.

Floriana Halili, LVV- Faleminderit Kryesuese, drejtor tek mallrat dhe shërbimet tek pajisjet tjera e shohim se ne 2023 është shuma 24030€ ne vitin 2024 është shuma 6364€, ndërsa ne vitin 2025 është shuma 74,631€, pse është kjo diferencë kaq e madhe e vlerës neper vite, dhe çka përfshin këtu, dhe tu kisha lut herave tjera raportin me cek edhe ma ne detaje se çka përfshin, tjetër kemi edhe te sigurimi i automjeteve kemi diferenc te vlerave neper vite, a mundeni me na tregu se çka përfshin sigurimi i automjeteve, faleminderit shume.

Behxhet Maliqi, DBF – Faleminderit për pyetjet sigurimi i automjeteve është sigurimi i auto përgjegjësisë, pajisjet tjera janë blere nga drejtoria e arsimit për kabinete te shkollave.

Kastriot Duraku, DKA – Faleminderit shume për pajisjet tjera janë blere tableta, laboratorë .

Hysni Mehani-LVV: Ne fakte unë nuk kam besu qe ky nuk është raporti i fundit i buxhetit, kame mëndu se ne marse vije raporti përfundimtar, a është kështu për ata nuk po du edhe me koment, ajo çka kisha dashtë drejtor se kur te vije raport ne mars me i pasur do sqarime shtese shembull tek investimet kapitale qe është ajo kryesorja qito si jan shpenzime te gjykatave shpenzime te vendimeve gjyqësore me u specifiku me mire, sepse këtu del se projekti është realizu qind per qind e ne realitet nuk është realizu fare sepse i është marre komplet buxheti dhe nuk del e sakte kjo ne raport nëse ska naj sqarim me detaj, pastaj e sheh si buxheti te ka shku 28% e e paraqet buxhetin te realizun atje 98% te lutna qita me na e sqaru.

Behxhet Maliqi, DBF –faleminderit kjo është kompetencë e thesarit se ku i merr mjetet, ata e zgjedhin se ku dojne me i marrin, ky raport është i bazun ne para te gaqme, ktu shihen ku jan marr mjetet ne cilat kategori, raporti paraqet përqindjen e realizimit te buxhetit.

Hysni Mehani-LVV: Ti shtohet edhe një kolon projekti i realizun 0 buxheti i shpenzun 100% edhe është e qarte se çfarë ka ndodh.

Behxhet Maliqi, DBF – Po për me pasur ma te qarte mundem me shtu edhe një kolon.

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura – Po përpiqem një sqarim me japë pasi qe kemi përvojë edhe rreth kësaj çështje, kjo forme e raportimit financiar është forme zyrtare qe Ministria e financave kështu e pranon, për sqarime këtu mundeni me jap sqarime me ne detaje a Ministrisë i dërgohet forma standarte e raportimit.

Kryesuesja:Pasi qe nuk ka tjerë për diskutim, atëherë shkojmë ne votim, konstatojmë se me 17 vota për asnjë kundër dhe 5 abstenime përkrahet raporti financiar janar – dhjetor 2025, vazhdojmë me piken e radhës, Propozim-vendim për miratimin e Raportit Përfundimtar Nr.09-052/01-0052869/25, i datës 18.12.2025, i hartuar nga komisioni komunal, për vlerësimin e dëmeve te shkaktuara kryesisht nga zjarret, era, breshëri, ngricat dhe fatkeqësitë tjera, për muajin Korrik-Dhjetor 2025, raporton drejtori DSHP, Arber Geci

Arber Geci DSHP- Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për te gjithë, fillimisht ju uroje mandatin te gjithëve, pasi qe jam ne fillim për mandatin e jomë duke i percjellur punët ne drejtori, po ja kaloj për prezantim te raportit Kryetarin e komisionit Faton Osmani.

Faton Osmani Kryetar i komisionit për dame- Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për te gjithë, para jushe po paraqes raportin përfundimtar te nxjerr nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve te dëmeve te shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore te cekura ne raport për periudhën korrik dhjetor 2025, pas vlerësimit ne teren te gjithsej 24 raste 18 ne bujqësi dhe 6 ne ekonomi familjare, ne vlere totale 421,30.70€, nuk po e zgjati me shume e qe te gjitha i keni ne raport prej qe ta miratoni e ti përcjellim me tutje për AME, faleminderit.

Hysni Mehani-LVV: Faleminderit, ne parim jemi me përkrah çdo qytetare qe ka psu dame dhe nuk na ndan përgjegjësia me mbështet ata si kan pasuar dëme, mirëpo material ka pake shume sqarime pak, nuk ka detaje, shembull thatësia nuk e njohim cili është dëmi , kështu po na kërkon vote bllanko me mirëbesim, pastaj fatkeqësi natyrore nuk mundemi me qujt kanalizimin, puna e

njeriut e shkakton, tu kisha lut me qene me sqaru, konkretisht qito vlerat e mëdha te thatësia çka është dëmi,

Faton Osmani Kryetar i komisionit për dame- Atëherë te vlerësimi te rastet e zjarrit është komisioni kompetent se e ka bere vlerësimin, te thatësia është inxhinieri i urbanizmit behet fjale për një shtëpi ne lagjen 3 qe është dotmtuar ne tërësi, qe i kemi dëshmitë për te.

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura – U kyça për sqarime shtese është një raste shtëpia është dëmtuar, e prof. Idriz Ukes ka ardh te unë i kame thëne me bere kërkesë me vlersu komisioni, ka qene mire edhe e si Komune me pas fonde për këto raste.

Hysni Mehani-LVV: Nuk po kërkoj me shume vetëm sqarime te nevojshme.

Afrim Kabashi-NSD:- Faleminderit Kryesuese, e përkrahi çdo iniciative te mire, e dimë si ka pasur dëme nga fatkeqësitë natyrore.

Kryesuesja: Pasi qe nuk ka tjerë për diskutim, shkojmë me votim konstatojmë se me 23 vota per asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet Propozim-vendim për miratimin e Raportit Përfundimtar Nr.09-052/01-0052869/25, i datës 18.12.2025, i hartuar nga komisioni komunal, për vlerësimin e dëmeve te shkaktuara kryesisht nga zjarret, era, breshëri, ngricat dhe fatkeqësitë tjera, për muajin Korrik-Dhjetor 2025, vazhdojmë me piken e radhës Propozim-vendim për Rishqyrtimin e Vendimit Nr.01-020/01-0000460/26, i datës 05.01.2026, për Formimin e Komitetit për Politik e Financa (KPF), Raporton Kryesuesja e kuvendit, znj.Adelina Spahiu-Alija, propozohet qe anëtarja e 7 nga entiteti i pare politik te zëvendësohet me një anëtare te gjinisë femërore nga entiteti i dyte politik për te siguruar kështu përfaqësim te barabarte politik dhe gjinor ne përbërjen e komitetit për politik dhe financa, bazuar ne rekomandimin e Mapl, e hap diskutimin.

Alban Berisha, PDK – Përshëndetje për te gjithë, bazuar ne rekomandimin e MAPL grupi parlamentar i PDK, e tërheq nga përbërja e komitetit për politik dhe financa znj. Donika Mustafa ne mënyrë qe te vazhdojmë tutje, faleminderit.

Kryesuesja: Me qe është procedurë duhet ta hedhim ne votim tërheqjen e Donika Mustafa nga kpf, shkojmë ne votim, konstatojmë se me 19 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratohet propozimi për largim nga kpf e Donika Mustafa, atëherë ne kuadër te obligimeve ligjore dhe bazuar ne rekomandimin e Mapl per riqyrtimin e vendimit te kpf, kërkoj nga subjekti i dyte ta propozoj nga gjinia femrore ne menyre qe te respektohet barazia gjinore, fjalën ja kaloj

Nezir Bejta, LVV- Nënkryetar po doni me na anashkalu ne si grup para nje muaji e keni formu komitetin qe eshte ne kundërshtim me ligjin dhe Mapl ja u ka kthy ne rishqyrtim jo veq Donika Mustafa po ju duhet me dhënë dorëheqje krejt, rishqyrtimi behet komplet, ky propozimi qe ka ardhur është ne kundërshtim me kundërshtimin e Mapl askund ne atë kundërshtim nuk thotë se subjekti i dyte duhet ta propozoj femër për komitet, ju pe shkelni edhe udhëzimin administrativ edhe rekomandimin e MAPL, ne propozojm prape Hysni Mehani ju vazhdoni.

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura – Faleminderit, prof. E para kjo nuk është kompetencë e imja por e kuvendit, ju e zgjedhni këtë çështje nuk i ndërhy kurrë kuvendit për këtë çështje.

Floriana Halili, LVV- Faleminderit Kryesuese, po besoj qe e dini se unë qe 4 vjet kame refuzu me qene pjese e kpf, domethënë prapë e refuzoj, është detyre e juve mos me i pa grat vetëm kuot gjinore me i përfshi ne vendimmarrje, edhe ne ekzekutiv z. Nura vetëm dy drejtoresha.

Kryesuesja: Pasi qe nuk ka tjerë për diskutim shkojmë ne votim te propozimit nga Nezir Bejta për Hysni Mehani për komitet për politik dhe financa, konstatojmë se me 3 vota për 19 kundër dhe asnjë abstenim Hysni Mehani nuk merr vota te mjaftueshme për te qene pjese e komitetit për politik dhe financa, vazhdojmë me propozimin tjetër.

Alban Berisha, PDK – Faleminderit Kryesues, grupi parlamentar i PDK, gjithmonë ne rrethana te tilla është munduar te gjej zgjidhje, për ta respektua e MAPL, për ta ruajtur kuotën gjinore dhe për ta funksionalizuar komitetit për politik dhe financa, propozoj kolegen Floriana Halili.

Kryesuesja: Atëherë shkojmë ne votim te propozimit te grupin parlamentar te PDK, per Floriana Halili, konstatojmë se me 18 vota për 3 kundër dhe asnjë abstenim, Floriana Halili merr votat e mjaftueshme për te qene pjese e kpf, pasi qe është procedurë shkojmë ne votim te propozim vendimit për rishqyrtim te vendimit për formimin e komitetit për politik dhe financa, konstatojmë se me 18 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet propozim – vendimi për rishqyrtimin e vendimit për formimin e komitetit për politik dhe financa, vazhdojmë me piken e radhës propozim për rishqyrtimin e vendimit nr 01-463/04-00000466/26 i datës; 05.01.2026 për miratimin e listës se përgjithshme dhe te veçantë te pronave të paluajtshme të Komunës, qe planifikohen për dhënie ne shfrytëzim personave fizik / juridik për vitin 2026,raporton.

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura –Faleminderit atëherë ky vendim është kthyer për definimin e periudhës se dhënies është rregulluar ma shume ka pas probleme teknike lista, është rregulluar duke u bazuar ne rekomandimet e MAPL, kërkoj qe ta përkrahni faleminderit.

Kryesuesja: Faleminderit nënkryetar, e hap diskutimin fjalën ja kaloj

Hysni Mehani-LVV: Mos i reaktivizoni gjerat, atëherë e kame thënë se duhet me percaktu kohen e dhënien ne shfrytëzim, nuk është çështje teknike është kruciale, supstanciale, kjo tregon mendsin politike qe keni.

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura – Faleminderit shume, nuk ka relativizim, është fakte se e njëjta ministri vitin e kaluar e ka vlersu kështu, mirëpo na e respektojmë rekomandimin e MAPL, kështu shumicës se komunave ja u ka kthy për te njëjtën çështje.


Kryesuesja: Pasi qe nuk ka tjerë për diskutim shkojmë ne votim, konstatojmë se me 19 vota per 3 kundër dhe 2 abstenime miratohet propozim për rishqyrtimin e vendimit nr 01-463/04-00000466/26 i datës; 05.01.2026 për miratimin e listës se përgjithshme dhe te veçantë te pronave të paluajtshme të Komunës, qe planifikohen për dhënie ne shfrytëzim personave fizik / juridik për vitin 2026, pyetjet e këshilltareve i kalojmë për seancën e radhës, me kaq i mbylli seancën..

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit





Republika e Kosovës

Republic Kosova

Republic of Kosovo

Nr.

No. 02-020/01-0006728/26

Data.

18.02.2026

Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58, shkronja h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 paragr. 5.2, nenit 7 nenit 8 paragr. 2 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, sipas nenit 50 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, Kuvendit të Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë _____ 2026, Kryetari i Komunës

PROPOZON

- I. Miratimin e vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Kompania Regjionale e Mbeturinae "Uniteti" SH.A Mitrovicë, me mandat katër (4) vjeçar, i cili përfundon me përfundimin e mandatit të Kuvendit Komunal.
- II. Komisioni Komunal i Aksionarëve përbëhet prej tre anëtarëve si vijon: një (1) anëtarë propozohet nga Kryetari i Komunës dhe dy (2) anëtarë nga Kuvendi Komunal, të cilët do të ushtrojnë të drejtat e aksionarit në Kompaninë Regjionale të Mbeturinae "Uniteti" SH. A - Mitrovicë.
- III. Komisioni Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësisë të cilat u janë dhënë me ligj. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësisë.
- IV. Me miratimin e këtij propozimi, shfuqizohet vendimi Nr.01-020/01-0009849/22, të datës 02.03.2022, konform nenit 53, nenit 57 paragr.1 dhe nenit 58 paragr.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- V. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së

Kryetari i Komunës


Sami Lushtaku





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SKENDERAJ/OPŠTINA SKENDERAJ/MUNICIPALITY OF SKENDERAJ
Nr. 02-020/01-0006731/26
Data 18-02-2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58, shkronja h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 paragr. 5.2, nenit 7 nenit 8 paragr. 2 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, sipas nenit 50 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, Kuvendit të Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë _____ 2026, Kryetari i Komunës i:

PROPOZON

- I. Miratimin e vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Eko-Natyra SH.A - Skenderaj”, me mandat katër (4) vjeçar, i cili përfundon me përfundimin e mandatit të Kuvendit Komunal.
- II. Komisioni Komunal i Aksionarëve përbëhet prej tre anëtarëve si vijon: një (1) anëtarë propozohet nga Kryetari i Komunës dhe dy (2) anëtarë nga Kuvendi Komunal, të cilët do të ushtrojnë të drejtat e aksionarit në Ndërmarrjen Publike Lokale “Eko-Natyra SH.A - Skenderaj”.
- III. Komisioni Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi.
- IV. Me miratimin e këtij propozimi, të shfuqizohet Vendimi Nr.01-020/01-0009850/22, i datës 02.03.2022, konform nenit 53, nenit 57 paragr.1 dhe nenit 58 paragr.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- V. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së

Kryetari i Komunës

Sami Lushtaku





Republika e Kosovës
Republic Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. No. 02-020/01-0006725/PG
Data. 18. 02. 2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58, shkronja h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 50 paragr. 50.1 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës. 03.12.2008, Kuvendit të Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2026, Kryetari i Komunës i:

PROPOZON

- I. Miratimin e vendimit për zgjedhjen e përfaqësuesve të Komunës, të cilët do të përfaqësojnë Komunën në Asociacionin e Komunave të Kosovës.
- II. Zgjedhja e përfaqësuesve të cilët do të përfaqësojnë Komunën në AKK përbëhet prej tre anëtarëve si vijon: Kryetari i Komunës, një (1) anëtar, dhe nga Kuvendi i Komunës dy (2) anëtar, numri i të cilëve do të jetë në proporcion me numrin e votave që subjektet politike i kanë fituar në Kuvendin e Komunës.
- III. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së

Kryetari i Komunës


Sami Lushtaku





Republika e Kosovës
Republic Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. 02-020/01-0006898/26

Data 20-02-2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Kryetari i Komunës së Skenderajt, duke u bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ndërlidhur me nenin 50, paragrafi 1 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.110-385 të datës: 03.12.2008, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane dhe në përputhje me Rregulloren Nr.01-110/01-0047005/20 për Organizimin, Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane të Komunës së Skenderajt, i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e rregullt të datës _____.2026, të miratojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

- I. Propozohet miratimi i vendimit për themelimin e Komisionit të Kuvendit të Komunës për Zgjedhjen e Këshillave Lokale, në këtë përbërje:
 1. Katër (4) anëtarë nga Kuvendi i Komunës (nga subjekte të ndryshme);
 2. Një (1) anëtar nga Ekzekutivi;
 3. Një (1) anëtar nga Shoqëria Civile;
 4. Një (1) anëtar nga lokaliteti (fshati, vendbanimi apo lagja).
- II. Detyrë e Komisionit është që të bëjë koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave Lokale dhe për punën e tij i raporton Kuvendit të Komunës.
- III. Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.
- IV. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së

Kryetari i Komunës


Sami Lushtaku





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKENDERAJ	
Nr.	
No.	02-020/01-0006897/26
Data.	
Data.	20.02.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të kompetencave të përcaktuara me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 50 paragrafi 1 shkronja h) të Statutit Nr.01-110-385 të Komunës së Skenderajt të datës 03.12.2008 dhe nenin 7 të Rregullores Nr.01-110/01-0047005/20 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, të Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal, të datës _____, Kryetari i Komunës propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

- I. Propozohet miratimi i vendimit për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e ankesave përkritazi me zgjedhjen e Këshillave Lokale, në përbërje prej tre (3) anëtarëve nga Kuvendi i Komunës.
- II. Detyrë e Komisionit është që të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave dhe brenda afatit prej 15 ditësh nga data e parashtrimit të ankesës, t'u kthej përgjigje me shkrim parashtruesve të ankesave, si dhe për punën e tij t'i raportoj Kuvendit të Komunës.
- III. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Propozimi i dërgohet:

- Kryesueses së Kuvendit
- Arkivit

Kryetari i Komunës

Sami Lushtaku





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI KOMUNAL / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPSTINA OPSTINE	
SKENDERAJ	
Nr.	
No.	01-020/01-0006954/26
Data.	
Data.	20.02.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës / Skupstina Opstine / Municipal Assembly

Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, duke u mbështetur në nenin 53 paragraf 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 12 paragraf 2 shkronja d) nenin 51 paragraf 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragraf 2 dhe nenin 4, 5 dhe 6 paragraf 3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, ndërlidhur me nenin 13 paragraf 1, nënparagraf 1.1, i Rregullores (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunave dhe neni 14 paragraf 1, 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të dt.03.12.2008, si dhe bazuar në Rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-10/18, dt.13.02.2026, në seancën e rregullt të datës _____, Kuvendit të Komunës i propozon për miratim këtë:

PROPOZIM

- I. Rishqyrtimin e Vendimit Nr.01-020.01-00004914/26, të datës 03.01.2026, të miratuar në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Skenderajt të datës 30.01.2026, për Formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
- II. Në nenin I të Vendimit të lartcekur anëtarja **Floriana Halili** nga entiteti i dytë politik Lëvizja Vetëvendosje të **zëvendësohet** me një anëtar tjetër nga i njëjti subjekt politik, për të siguruar kështu përfaqësim të barabartë në përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 dhe Rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-10/18, dt.13.02.2026.
- III. Të shfuqizohet në tërësi Vendimi Nr.01-020.01-0004914/26, të datës 03.02.2026.
- IV. Ky propozim-vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

- Arkivit
- Anëtarëve të KK-së

Kryesuesja e KK-së

Adelina Spahiu Alija



MAPLE - IZLAZNA - OUTGOING
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT OF KOSOVO
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministry of Local Government Administration
 020-10/8
 13.02.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Sami Lushtaku, Kryetar i Komunës së Skenderajt Adelina Spahiu-Alija, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Nga:	Erblin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të aktit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës së Skenderajt

I nderuar Kryetar,
 I nderuar Kryesuese,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr.01-020/01-0004914/26 për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-020/01-0000460/26 për formimin e komitetit për politikë dhe financa
 I miratuar më datë: 30.01.2026
 I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.02.2026
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2026, ka miratuar vendimin Nr.01-020/01-0004914/26 për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-020/01-0000460/26 për formimin e komitetit për politikë dhe financa.

Vendimi Nr.01-020/01-0004914/26 për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-020/01-0000460/26 për formimin e komitetit për politikë dhe financa, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht nenin 52, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe me Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë.

Neni 52, paragrafi 52.1, i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale përcakton se: komiteti për politikë dhe financa kryesohet nga kryesuesi i kuvendit të komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në kuvendin e komunës.

Ndërsa neni 5, paragrafi 1 dhe 2, i Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, përcakton se "komiteti për politikë dhe financa kryesohet nga kryesuesi i kuvendit të komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në kuvendin e komunës. Entiteti politik më numrin më të madh të vendeve, varësisht nga përqindja e përfaqësimit në kuvend do të përfaqësohet edhe në komitet, vazhdon më entitetin e dytë që ka numrin më të madh të anëtarëve të kuvendit e kështu me radhë derisa të ndahen të gjitha vendet në komitet".

Është e drejtë e subjekteve politike të cilave ju takojnë vendet në komitetin për politikë dhe financa, që të propozojnë nga subjekti i tyre politikë anëtarët në komitetin për politikë dhe financa. Në asnjë rast një subjekti politikë nuk mund të i kufizohet e drejta e propozimit të një anëtarit nga subjekti politikë tjetër siç është vepruar në kuvendin e komunës së Skenderajt.

Gjithashtu, kuvendi i komunës së Skenderajt, nuk mund të kërkojë nga një subjekt politikë të cilit i takon vendi në komitet për politikë dhe financa, që propozimi i tyre duhet të jetë nga gjinia femërore, siç është vepruar në këtë rast nga kuvendi i komunës së Skenderajt.

Kuvendi i komunës duhet të kujdeset që përfaqësimi gjinor në komitetin për politikë dhe financa të jetë në pajtim me nenin 5, paragrafin 3, të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Skenderajt duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtojë dhe të harmonizojë aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr.
No. 01-020/01-000460/26
Data
Data 03.02.2026

04.02.2026
026-10/7
Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipal Assembly

Në mbështetje të nenit 11 nenit 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), neni 52 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 50 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, neni 3 paragrafi 2, neni 4 dhe 5 neni 6 paragrafi 4 neni 12 paragrafi 1, i Udhëzimit Administrativ Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, ndërlidhur me nenin 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Rregullores (MAPL) Nr.02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunave, duke u bazuar në rekomandimin e MAPL-së Nr.020-10/13, të datës 14.01.2026, dhe neni 30 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 30.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

(Për Rishqyrtimin e vendimit Nr.01-020/01-0000460/26 të datës 05.01.2026)

Neni 1

Miratohet propozim-vendim Nr. 01-020/01-0003480/26, i datës 22.01.2026, për Rishqyrtimin e vendimit Nr.01-020/01-0000460/26 të datës 05.01.2026, për zëvendësimin e anëtares të Komitetit për politik dhe financa z.j. Donika Mustafa, nga subjekti politik (PDK), Zëvendësohet me anëtarin z.j. Floriana Halili, nga subjekti Politik (LVV) nga gjinia e njëjtë, duke u ruajtur përfaqësimin politik dhe kuotën gjinore në KPF, duke u bazuar në rekomandimin e MAPL-së Nr.020-10/13, të datës 14.01.2026.

Neni 2

Mandati i anëtares së zëvendësuar z.j. Floriana Halili, nga subjekti Politik (LVV) është i njëjti me mandat të Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Pjesët tjera të vendimit Nr.01-020/01-0000460/26 të datës 05.01.2026, mbesin në fuqi dhe të pa ndryshuara.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb – faqen të Komunës.


Vendimi i Dërgohet :

1x1 Anëtarëve të zëvendësuarve,
1x1 MAPL-së,
1x1 Zyrës së Kryetarit,
1x1 Arkivit,
1x1 Dosjes.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit

Direkcija za Urbanizam i Zaštitu Ambiena
Department of Urban and Environmental Protection

Në bazë të nenit 17 shkronja b), nenit 58 shkronja h) ndërlidhur me nenin 62.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 6 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, nenit 11, paragrafi 1.2 dhe nenit 15 i Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, ndërlidhur me nenin 63 shkronja b) të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 i dt.03.12.2008, dhe në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ MMPIH Nr. 11/2015 mbi Elementet dhe dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit si autoritet përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor, i propozon Kuvendit të Komunës së Skenderajt, që në seancën e rregullt të datës _____.____.2026, të miratojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

(Për miratimin e vendimit për iniciimin e procedurës së hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Skenderajt 2026-2034)

- I.** Të miratohet vendimi për iniciimin e procedurës së hartimit të **Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Skenderajt 2026-2034**.
- II.** Plani Zhvillimor Komunal do të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.
- III.** Propozimi për iniciimin e procedurës së hartimit të PZHK-së së cekur në pikën një të këtij propozimi, vjen pasi që Plani Zhvillimor Komunal (2017-2025) ka kaluar periudhën tetë (8) vjeçare nga data 31.12.2025.
- IV.** Plani Zhvillimor Komunal 2026-2034 do të hartohet nga një kompani profesionale e kontraktuar nga DUMA, në bashkëpunim edhe me ekspertë e fushës, dhe pas kalimit të procedurave të diskutimit publik, do të propozohet për miratim në Kuvendin Komunal.
- V.** Propozimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet :

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së
- Kryetarit të Komunës

Drejtori i Drejtorisë

Arbnor Çitaku



1. Çfarë hapa konkretë ka ndërmarrë Komuna e Skenderajt për krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë?

2. A ka komuna një plan të strukturuar për dokumentimin, arkivimin dhe botimin e historisë së Skenderajt (dëshmi, fotografi, dokumente, kujtime), dhe pse deri më tani kjo fushë është lënë kryesisht në iniciativa individuale?

3. A ka Komuna e Skenderajt ndonjë strategji konkrete për mbajtjen e fermerëve të rinj në bujqësi?

Vlora Jashari-PDK

1.)Pyetje per Drejtorin per Sherbime Publike;

A pritet në vazhdimin e punimeve në projektin e ndriçimit publik nëpër fshatra,projekt i lën në gjysmë te realizimit si psh në disa lagje te fshatra te fshatit Polac!

2.)Pyetje per Drejtorin per Arsim; Drejtor a pritet per fillim e punimeve per ndertimin e çerdhes femijve në fshatin Polac,projekt i premtuar nga mandati i kaluar!

3.)Pyetje per Drejtorin per Urbanizem

Drejtor a pritet në vazhdimin e projektit te kyqjeve individuale, dhe kure pritet te ketë ujë per pije nga rrjeti i ujësjellsit per banoret e fshatit Makermal!

Afrim Kabashi NSD

Kërkesë për ndërmarrje masash pas reshjeve në rrugën Llaushë – Skenderaj

I nderuar Drejtor,

Pas reshjeve të fundit në rrugën Llaushë, Skenderaj, nga përroi “I Keq” ujit ka bartur zhavori dhe ka krijuar në skajin e rrugës një kanal të rrezikshëm. Si pasojë e kësaj gjendjeje, kanë ndodhur edhe aksidente në atë pjesë të rrugës.

Do të ishte e nevojshme të ndërmerren masa për mbylljen dhe sanimin e këtij kanali, me qëllim të rritjes së sigurisë për qytetarët dhe pjesëmarrësit në trafik.

Me respekt,

Kushtrim Dragaj

I nderuar Drejtor i Gjeodezisë,

Me datë 08 prill 2026 bëhen dy (2) vite nga vendosja e gurthemelit të xhamisë së re pranë Shkollës Profesionale, në parcelën e ndarë nga Komuna e Skenderajt për Bashkësinë Islame të Kosovës – Dega Skenderaj.

Kërkesa e Bashkësisë Islame është e protokolluar në Komunë dhe projekti është i përfunduar në letër, i gatshëm për aplikim për leje ndërtimore. Po ashtu, ju njoftoj se donatori ka qenë i lajmëruar që nga fillimi për realizimin e këtij projekti.

Andaj, kërkoj nga ju që kjo çështje të procedohet pa vonesa dhe, në mundësinë e parë ligjore, të silllet në Kuvend Komunal për dhënie në shfrytëzim dhe votim, në përputhje me ligjet në fuqi.

Kërkoj veprime konkrete dhe mosneglizhencë, duke pasur parasysh rëndësinë publike dhe interesin qytetar të këtij projekti.

Me respekt,
Kushtrim Dragaj

Pyetje për drejtorin e DKA-së, zotin Kastriot Duraku

Si asambletist i Kuvendit Komunal, ju drejtohem me disa pyetje që janë shqetësuese, jo vetëm për mua.

Pyetja e parë ka të bëjë me rrjedhën e ujërave të zeza në oborrin e gjimnazit “Hamëz Jashari”, që paraqet një rrezik permanent për shëndetin e nxënësve. Zoti Drejtor, a keni njohuri për rrjedhën e këtij uji dhe cili do të jetë veprimi juaj?

Edhe pyetja tjetër ka të bëjë me gjimnazin, të cilit gjatë renovimit i është mbyllur njëra hyrje, duke shkaktuar kështu vështirësi në lëvizjen e nxënësve. Pyetja ime është: a do ta hapni hyrjen tjetër, ashtu siç ishte më parë, dhe a do të ketë shkallë emergjente për shkak të sigurisë së nxënësve, në rast të fatkeqësive natyrore?

Pyetja e tretë ka të bëjë me SHFMU “Rifat Mëziu”, e cila u formua me bashkimin e dy shkollave, “Shaban Jashari” dhe “Ahmet Delia”, nga klasa e 6 deri 9. Pyetja është: cila ishte arsyeja që e zgjodhet këtë model, pasi që shumë pak shkolla e praktikojnë në Kosovë?

Nezir Bejta, këshilltar komunal - LVV

Falemnderit!